

Përmbledhje mbi të rejat më të fundit

Urdhër Nr. 180, datë 22.7.2020 për shpalljen e disa ndryshimeve në standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe kontabilitetit

Në mbështetje të nenit 3, pika 4, të ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, Ministër I Financave dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj Urdhëroi:

1. Shpalljen e disa ndryshimeve të:

- Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar *Nr. 16* “Koncesionet e Qirasë të Lidhura me Covid-19”;
- Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar *Nr. 3* “Kombinimet e Biznesit”;
- Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar *Nr. 1* “Adoptimi për herë të parë i SNRF-ve”; Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar *Nr. 9* “Instrumentet Financiare”;
- Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit *Nr. 41* “Bujqësia”;
- Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit *Nr. 37* “Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e Kushtëzuara”;
- Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit *Nr. 16* “Aktivet Afatgjata Materiale (Toka, Ndërtesa, Makineri e Pajisje)”.

2. Ndryshimet e SNRF-së nr. 16, të publikuara në vitin 2020, kanë datë efektive 1 qershor 2020.

3. Ndryshimet e SNRF-së nr. 3, SNRF-së nr. 1, SNRF-së nr. 9, SNK-së nr. 41, SNK-së nr. 37 dhe SNK-së nr. 16, të publikuara në vitin 2020, kanë datë efektive 1 janar 2022.

Për të lexuar ndryshimet në secilin Standard, klikoni më poshtë:



<https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/07/22/180/d6ad15f6-de70-482d-b58e-b01427f93b9a>

Miratohet VKM Nr.576 datë 22.07.2020 për disa ndryshime në VKM Nr.953 datë 29.12.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”

Në bazë të vendimit nr. 576, datë 22.07.2020 për disa ndryshime në vendimin Nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli i Ministrave vendosi që:

- Kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar është qarkullimi prej 10 000 000 lekësh në një vit kalendarik. Personi i tatueshëm ka të drejtë të zgjedhë të zbatojë regjimin normal të TVSH-së, në përputhje me përcaktimet e nenit 120 të ligjit, nëse qarkullimi vjetor është më i madh se 5 000 000 lekë.

Në datë 29.07.2020 AMF ka miratuar disa ndryshime në rregulloret për shoqëritë audituese të kompanive në tregjet nën mbikëqyrje

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar më 29 korrik 2020 disa ndryshime në Rregulloren nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit” dhe Rregulloren nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të SIK dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”. Qëllimi i këtyre ndryshimeve është rritja e cilësisë së auditimit, referuar praktikave më të mira rregullative.

Disa nga ndryshimet për përzgjedhjen e shoqërive audituese nga kompanitë e sigurimit janë:

- Shoqëria e auditimit duhet të ketë si pjesë të brendshme të strukturës së shoqërisë, burimet njerëzore me kompetencat e duhura profesionale për të kryer auditimin ligjor, ku ekipi i auditimit (pa përfshirë ortakun kryesor të auditimit dhe



aktuarin) të ketë minimumi dy anëtarë me përvojë në mbikëqyrjen dhe kryerjen e angazhimeve të auditimeve ligjore.

- I njëjti ekip auditimi, përfshirë edhe aktuarin e kontraktuar nga shoqëria e auditimit, të mos jetë i angazhuar në më shumë se tre auditime të shoqërive të sigurimit.
- Të mos kenë konflikt interesi me shoqërinë që auditon, sipas përcaktimeve të ligjit 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizmin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” dhe kërkesave përkatëse të Kodit të Etikës dhe ligjeve të fushës.
- Të ketë një aktuar vendas ose të huaj të certifikuar dhe të kontraktuar, i cili duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - të ketë përvojë, të paktën, 5 (pesë) vjeçare në fushën e aktuaristikës;
 - të mos jetë i angazhuar në të njëjtën kohë në kryerjen e shërbimeve aktuariale në një shoqëri tjetër sigurimi;
 - të mos ketë qenë i punësuar dhe mos të ketë ofruar kryerjen e shërbimeve aktuariale, në 2 vitet e fundit në shoqërinë që auditohet;
 - të mos ketë kryer shkelje të rënda të rregullave të profesionit të aktuarit dhe Kodit të Etikës.
- Letra e angazhimit të shoqërisë audituese duhet të përfshijë edhe trajtimin e çështjeve që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, për shoqëritë që janë subjekt i ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”. Ajo duhet të parashikojë:



- a) komunikimin e shoqërisë së auditimit me komitetin e auditimit
- b) letrën e drejtimit dhe
- c) letrën e përfaqësimit.
- Të depozitohet një vetëdeklarim nga aktuari i kontraktuar, në lidhje me:
 - ushtrimin e shërbimeve aktuariale gjatë 3 (tre) viteve të fundit dhe angazhimet për vitin në vijim;
 - përvojën e kërkuar në fushën e aktuaristikës si dhe zbatimin e rregullave të profesionit aktuarial dhe kodit të etikës.
- Autoriteti ka të drejtë të refuzojë shoqërinë audituese, e cila gjatë kontrollit të cilësisë së punës të tyre në tre vitet e fundit, në rastet kur është kryer një kontroll i tillë, është vlerësuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, nën notën C.

Disa nga ndryshimet për përzgjedhjen e shoqërive audituese nga shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar janë:

- Shoqëria e auditimit duhet të ketë si pjesë të brendshme të strukturës së shoqërisë, burimet njerëzore me kompetencat e duhura profesionale për të kryer auditimin ligjor, ku në ekipin e auditimit të ketë minimumi dy anëtarë (pa përfshirë ortakun e angazhimit) të cilët të jenë me eksperiencë në mbikëqyrjen dhe/ose kryerjen e angazhimeve të auditimeve ligjore në institucione financiare.
- I njëjti ekip auditimi, të mos jetë i angazhuar në më shumë se dy auditime të shoqërive administruese.



- Të mos jetë subjekt i masave disiplinore nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, për aq kohë sa kjo masë është në fuqi.
- Autoriteti mund të refuzojë shoqërinë audituese të propozuar nga shoqëria administruuese, nëse:
 - Nuk përmbushen kriteret dhe kërkesat e parashikuara në Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, Ligjin nr. 56/2020 “Për SIK” dhe të kësaj rregullore;
 - Shoqëria audituese në rastet kur është kryer një kontroll i cilësisë së punës, është vlerësuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, nën notën C.

Për të lexuar rregulloret, klikoni këtu:

https://amf.gov.al/pdf/ligje/Rregullorenr37_1.pdf

https://amf.gov.al/pdf/ligje/Rregullorenr_89.pdf